



Financuar nga
Bashkimi Evropian

Përmbledhje e Raportit për Monitorimin e Progresit të Zbatimit të Strategjisë së Rishikuar të Ujërave 2023-2027 dhe Planit të Veprimit 2023-2025



Promoting Universal
Access to Clean Water



**RILINDJA
GJELBËR**



Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Rilindja Gjellbër (ish Let's Do It Peja), zbatues i projektit “Promovimi i Qasjes Univerzale në Ujë të Pastër” dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Zyrës në Prishtinë.



PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

PËR MONITORIMIN E PROGRESIT TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË RISHIKUAR TË UJËRAVE 2023–2027 DHE PLANIT TË VEPRIMIT 2023–2025

tetor, 2024

Shkurtesat

ARPL	Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore
ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Europian
DKU	Direktiva Kornizë e Ujërave
FLAWS	Projekti: Nxitja dhe Shfrytëzimi i Mundësive për Sigurinë e Ujërave
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KNU	Këshilli Ndërmintor për Ujëra
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
ME	Ministria e Ekonomisë
MIRU	Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
PMPL	Plani i Menaxhimit të Pellgjeve Lumore
UA	Udhëzim Administrativ
UPF	Uji i Pafaturuar

PËRMBLEDHJE E PROGRESIT DHE REKOMANDIME

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë

Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës është dokument kryesor planifikues në fushën e ujërave i hartuar në bazë të Ligjit Nr. 03/L-147 për Ujërat e Kosovës për periudhë kohore 20-vjeçare. Qëllimi i këtij dokumenti është që të ofrojë zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar të sektorit të ujërave duke i plotësuar nevojat për: furnizim me ujë, ujin për prodhimin e ushqimit, ujitje dhe bujqësi, industri, prodhim të energjisë, peshkim, turizëm, sport dhe rekreacion.

Bazuar në dispozitat e Ligjit për Ujëra, Strategjia është rishikuar në vitin 2023 për periudhën 5-vjeçare (2023–2027), rrjedhimisht ky vlerësim i zbatimit të Strategjisë është bërë kundrejt Strategjisë së rishikuar.

- Me Rishikimin e Strategjisë Shtetërore për Ujëra 2023–2027 janë përcaktuar **4 objektiva strategjike** si vijon:
 - 1) Kompletimi i kuadrit ligjor dhe konsolidimi i kornizës institucionale
 - 2) Sigurimi afatgjatë i ujit për shfrytëzuesit dhe siguria e digave ekzistuese
 - 3) Mbrojtja e resurseve ujore dhe mbrojtja nga ujërat duke siguruar mbrojtjen e ekosistemit dhe popullatës
 - 4) Përmirësimi i besueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve ujore
- Në kuadër të këtyre 4 objektivave strategjike janë përcaktuar **19 objektiva specifike**:
 - 3 objektiva specifike për objektivitn strategjik 1;
 - 2 objektiva specifike për objektivin strategjik 2;
 - 8 objektiva specifike për objektivin strategjik 3; dhe
 - 6 objektiva specifike për objektivin specifik 4.
- Për arritjen e secilit prej objektivave specifike janë planifikuar në total **70 veprime** si vijon:
 - **Gjithsej 14 për objektivin strategjik 1** – 9 për objektivin specifik 1, 3 për objektivin specifik 2, dhe 2 për objektivin specifik 3;
 - **Gjithsej 13 për objektivin strategjik 2** – 5 për objektivin specifik 2, dhe 8 për objektivin specifik 2;
 - **Gjithsej 26 për objektivin strategjik 3** – 2 për objektivin specifik 1, 2 për objektivin specifik 2, 2 për objektivin specifik 3, 6 për objektivin specifik 4, 4 për objektivin specifik 5, 3 për objektivin specifik 6, 4 për objektivin specifik 7, dhe 3 për objektivin specifik 8;
 - **Gjithsej 17 për objektivin strategjik 4** – 2 për objektivin specifik 1, 6 për objektivin specifik 2, 2 për objektivin specifik 3, 2 për objektivin specifik 4, 2 për objektivin specifik 5, dhe 3 për objektivin specifik 6.
- Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë është bërë për **secilin veprim** veç e veç, pastaj, bazuar në zbatimin e veprimeve, është bërë një vlerësim kuantitativ se në çfarë shkalle janë arritur objektivat specifike për secilin objektiv strategjik. Vlerësimi është bërë duke u bazuar në të dhënat e ofruara nga institucionet dhe organizatat përgjegjëse në pyetësorët e dërguar për këtë qëllim.

Vlerësimi sipas objektivave strategjike dhe rekomandimet

(i) OBJEKTIVI STRATEGJIK 1:

KOMPLETIMI I KUADRIT LIGJOR DHE KONSOLIDIMI I KORNIZËS INSTITUCIONALE

Vlerësimi për 14 veprimet e planifikuara në kuadër të 3 objektivave specifike për arritjen e këtij objektivi strategjik është si vijon:

- Kompletuar – 2
- Progres substancial – 2
- Progres i pjesshëm – 1
- Pa progres – 9


Për këtë objektivi strategjik ka pasur më pak progres në kuptim të veprimeve të ndërmarra krahasuar me objektivat tjerë strategjikë. Arritja e këtij objektivi strategjik është vlerësuar me K=0.29.

Sa i përket zbatimit të veprimeve specifike, në mënyrë të përmbledhur mund të konkludohet si vijon:

- **Të kompetuara** është vlerësuar se janë 2 veprime: (i) hartimi i koncept dokumentit për ligjin e ri për menaxhimin e resurseve ujore dhe ligjit për financimin e menaxhimit të ujërave, dhe (ii) hartimi i procedurave për grumbullimin, sistemimin dhe ruajtjen e informacioneve në sistemin informativ ujqor (SIU);
- **Progres substancial** është vlerësuar se ka pasur në 2 prej veprimeve: (i) hartimin e ligjit të ri për menaxhimin e resurseve ujore, dhe (ii) hartimin e ligjit për financimin e menaxhimit të ujërave.
- **Progres i pjesshëm** është vlerësuar për 1 prej veprimeve: (i) hartimi i ligjit të ri për rregullimin e shërbimeve të ujqit.
- **Pa progres** është vlerësuar për 9 prej veprimeve: (i) hartimi UA për procedurat për Leje Ujqore, (ii) hartimi dhe caktimi i formatit të librit ujqor, (iii) hartimi i katalogut informativ ujqor, (iv) vendimi për karakterizimin dhe klasifikimin e trupave ujqor sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, (v) vendimi për përcaktimin e kufijve të pasurisë ujore, (vi) hartimi i aktit nënligjqor për zonat e shërbimit të KRU-ve, (vii) krijimi i bazës ligjqore për certifikimin e personelit të KRU-ve, (viii) punësimi i 5 inspektorëve të ri të ujërave, (ix) organizimi i inspektorëve sipas pellgjeve lumore.

Rekomandohet që me prioritet të rritet dinamika dhe angazhimi i resurseve në zbatimin e masave dhe veprimeve për të cilat nuk ka pasur fare progres. Duke besuar se legjislacioni primar i hartuar dhe i proceduar në Kuvend do të miratohet në këtë legjislaturë, angazhim shtesë rekomandohet në veçanti në lidhje me nxjerrjen e akteve normative që dalin nga këto ligje si dhe në fuqizimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve të MMPHI për menaxhimin e resurseve ujore, përfshirë kapacitetet inspektuese në fushën e ujërave.

Figura 1: Paraqitja grafike e progresit në përmbushjen e objektivit strategjik 1



(ii) OBJEKTIVI STRATEGJIK 2:

SIGURIMI AFATGJATË I UJIT DHE SIGURIA E DIGAVE EKZISTUESE

Vlerësimi për 13 veprimet e planifikuara në kuadër të 2 objektivave specifike për arritjen e këtij objekti strategjik është si vijon:

- Kompletuar – 5
- Progres substancial – 1
- Progres i pjesshëm – 1
- Pa progres – 6

Ky është objektivi strategjik për të cilin ka pasur progres të pjesshëm në kuptim të veprimeve të ndërmarra për arritjen e tij. Shkalla e zbatimit të veprimeve të planifikuara për arritjen e këtij objekti strategjik është vlerësuar me K=0.48.

Sa i përket zbatimit të veprimeve specifike, në mënyrë të përmbledhur mund të konkludohet si vijon:

- **Të kompetuara** është vlerësuar se janë 5 veprime, prej tyre 2 në kuadër të objektiut specifik *Siguria dhe monitorimi i digave ekzistuese*:

- (i) pajisja me instrumente të monitorimit të digave ekzistuese, dhe
 - (ii) pajisja me sisteme të alrmit të digave ekzistuese
- dhe 3 në kuadër të objektivit specifik *Zhvillimi i resurseve të reja ujore*:
- (iii) Studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe shoqëror për digën e Dragaqinës
 - (iv) Studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe shoqëror për digën e Pollatës
 - (v) Studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe shoqëror për digën e Kuçicës.
- **Progres substancial** është vlerësuar se nuk ka pasur në asnjë prej veprimeve të planifikuara.
 - **Progres i pjesshëm** është vlerësuar se ka pasur në 2 prej veprimeve, prej tyre një në kuadër të objektivit specifik *Siguria dhe monitorimi i rregulltë i digave ekzistuese*:
 - (i) Batimetria dhe analiza e sedimentit të 6 digave ekzistuese;dhe 1 në kuadër të objektivit specifik *Zhvillimi i resurseve të reja ujore*:
 - (ii) Identifikimi dhe projektimi i digës së Kamenicës.
 - **Pa progres** është vlerësuar për 6 prej veprimeve, prej tyre 4 në kuadër të objektivit specifik *Zhillimi i resurseve të reja ujore*:
 - (i) Hartimi i projekti paraprak dhe vlerësimi të ndikimit mjedisor dhe shoqëror për digën e Firajës
 - (ii) Hartimi i projektit detaj dhe dokumentacionit tenderues për digën e Firajës
 - (iii) Aplikimi për projektin paraprak dhe vlerësimi mjedisor dhe shoqëror për fazën dy të sistemit të Lepencit (diga e Shtimes dhe kanali i Lepencit)
 - (iv) Hartimi i Studimit për investimet në resurset ujore në nivel nacionaldhe 2 në kuadër të objektivit specifik *Siguria dhe monitorimi i rregulltë i digave ekzistuese*:
 - (v) Vlerësimi i sigurisë së digës së Livoçit dhe rehabilitimi i saj
 - (vi) Operacionalizimi i digës së Livoçit


Pra, siç mund të shihet progres më të madh ka pasur në arritjen e objektivit specifik Siguria dhe monitorimi i digave ekzistuese, ku përpos adresimit të çështjes së digës së Livoçit, të gjitha veprimet tjera janë kompletuar ose janë në fazën e kompletimit.

Në anën tjetër, sa i përket zhvillimit të resurseve të reja ujore, janë kompletuar veprimet e planifikuara për hartimin e studimeve të fizibilitetit për 3 digat e planifikuara (Dragaçina, Kuçica dhe Pollata) dhe zhvillimi i projektit për digën e Kamenicës është në progres.

Rekomandohet që me prioritet të rritet dinamika dhe angazhimi në implementimin e aktiviteteve të planifikuara për digën e Firajës dhe fazën e 2-të të hidosistemit Lepenci si dhe operacionalizimi i digës së Livoçit.

Në figurën më poshtë është paraqitur në formë grafike progresi në zbatimin e veprimeve të planifikuara për arritjen e objektivit strategjik 2.

Figura 2: Progresi i zbatimit të veprimeve të planifikuara për arritjen e objektivit strategjik 2



(iii) OBJEKTIVI STRATEGJIK 3:

MBROJTJA E RESURSEVE UJORE DHE MBROJTJA NGA UJËRAT

Vlerësimi për 26 veprimet e planifikuara për arritjen e këtij objekti strategjik është si vijon:

- Kompletuar – 3
- Progres substancial – 5
- Progres i pjesshëm – 8
- Pa progres – 10

Progresi për këtë objektiv strategjik, në kuptimin kuantitativ të zbatimit të veprimeve është i pjesshëm. Shkalla e zbatimit të veprimeve të planifikuara për arritjen e këtij objektivit strategjik është vlerësuar me $K=0.41$.

Sa i përket zbatimit të veprimeve specifike, në mënyrë të përmbledhur mund të konkludohet si vijon:

- **Të kompetuara** është vlerësuar se janë 3 veprime, prej tyre 2 në kuadër të objektivit specifik *Monitorimi i ujërave nëntokësore*:

- (i) Funkcionalizimi i rrjetit të monitorimit të ujërave nëntokësore
- (ii) Përmirësimi i matjes hidrometrike, instalimi i pajisjeve dhe punimet e vogla civile

dhe 1 në kuadër të objektivit specifik *Mbrojtja nga përmbytjet*:

- (iii) Përfundimi i hartave të rrezikshmërisë dhe hartave të rrezikut nga përmbytjet

- **Progres substancial** është vlerësuar se ka pasur në 5 veprime të planifikuara, 1 prej tyre në kuadër të objektivit specifik *Hartimi i planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore*:

- (i) Aprovimi dhe zbatimi i PMPL të Drinit të Bardhë

1 në kuadër të objektivit specifik *Trajtimi i ujërave të ndotura urbane*:

- (ii) Sigurimi i financimit dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në Ferizaj,

dhe 3 në kuadër të objektivit specifik *Mbrojtja e burimeve të ujit të pijshëm*:

- (iii) Përfshirja e zonave të mbrojtura në hartat zonale të komunave
- (iv) Vendosja e shenjave paralajmëruese në zonat e mbrojtura
- (v) Ndalimi i ndërtimeve dhe aktiviteteve të ndaluara me vendime

- **Progres i pjesshëm** është vlerësuar se ka pasur në 8 prej veprimeve, prej tyre një në kuadër të objektivit specifik *Hartimi i planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore*:

- (i) Hartimi dhe miratimi i PMPL-ve Ibër, Morava e Binçës dhe Lepenc,

4 në kuadër të objektivit specifik *Trajtimi i ujërave të ndotura urbane*:

- (ii) Ndërtimi dhe inaugurimi i impiantit rajonal për trajtimin e ujërave të ndotura të Prishtinës, Fushë Kosovës, Obiliqit dhe Graçanicës
- (iii) Ndërtimi dhe inaugurimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në Mitrovicë (Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut, Vushtrri, Zveçan),
- (iv) Ndërtimi dhe inaugurimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në Gjilan,
- (v) Sigurimi i financimit dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në Podujevë,

dhe 3 në kuadër të objektivit specifik *Trajtimi i ujërave të ndotura industriale*:

- (vi) Identifikimi dhe krijimi i inventarit të të gjithë shkarkuesve industrial në sistemin e kanalizimit publik
- (vii) Identifikimi dhe krijimi i inventarit të të gjithë shkarkuesve industrial në ujërrjedha
- (viii) Zbatimi i obligimit për monitorim të cilësisë së ujit që shkarkohet

- **Pa progres** është vlerësuar për 10 prej veprimeve, prej tyre 2 në kuadër të objektivit specifik *Mbrojtja e lumenjve nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit*:

- (i) Hartimi i një plani të veprimit për trajtimin e eksploatimit të lumenjve
- (ii) Përcaktimi me vendim të Ministrit i segmenteve lumore ku mund të nxjerret rëra dhe zhavorri.

1 në kuadër të objektivit specifik *Trajtimi i ujërave të ndotura urbane*:

- (iii) Hartimi i studimit të fizibilitetit për trajtimin e ujërave të ndotura në Vushtrri, Malishevë, Drenas, Lipjan, Rahovec, Therandë, Viti, Istog, Deçan, Klinë dhe Kamenicë,

1 në kuadër të objektivit specifik *Trajtimi i ujërave të ndotura industriale*:

- (iv) Zbatimi i obligimit për trajtimin dhe paratrajtimin e ujërave të ndotura industriale para shkarkimit,

2 në kuadër të objektivit specifik *Mbrojtja nga përmytjet*:

- (v) Hartimi i planeve për menaxhimin e rrezikut nga përmytjet
- (vi) Përcaktimi i zonave erozive dhe caktimi i masave mbrojtëse

1 në kuadër të objektivit specifik *Mbrojtja e burimeve të ujit të pijshëm*:

- (vii) Kryerja e punimeve hulumtuese dhe hartimi i studimeve për mbrojtjen e burimeve të ujit të pijshëm,

dhe 3 në kuadër të objektivit specifik *Rregullimi dhe mbikëqyrja e shfrytëzimit të ujit për qëllime afariste*:


- (viii) Hartimi i UA për procedurat për leje ujore
- (ix) Hartimi i udhëzuesit për zhvillimin e procesit të dhënies së koncesionit.
- (x) Mbikëqyrja administrative dhe inspektuese e shfrytëzimit të ujit në pajtim me kontratën koncesionare.

Pra, siç mund të shihet progres më të madh ka pasur sidomos në zbatimin e veprimeve për arritjen e objektivit specifik *Monitorimi i ujërave nëntokësore*, por edhe të objektivave specifike *Mbrojtja e burimeve të ujit të pijshëm* dhe *Hartimi i planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore*. Progres modest ka pasur në zbatimin e veprimeve për objektivat specifike: *Trajtimi i ujërave të ndotura urbane*, *Trajtimi i ujërave të ndotura industriale* dhe *Menaxhimi i përmytjeve*, ndërkaq nuk ka pasur progres fare për veprimet e planifikuara për objektivat specifike *Rregullimi dhe mbikëqyrja e shfrytëzimit të ujit për nevoja afariste* si dhe *Mbrojtja e lumenjve nga eksploatimi i pakontrolluar i rërës dhe zhavorrit*.

Rekomandohet që me prioritet të ndërmerren veprime për mbrojtjen e lumenjve nga eksploatimi i pakontrolluar i rërës dhe zhavorrit dhe për rregullimin e problemit të shfrytëzimit të ujit për qëllime afariste, si dhe të rritet dinamika dhe angazhimi në zbatimin e veprimeve për menaxhimin e përmytjeve, trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe industriale dhe për mbrojtjen e burimeve të ujit të pijshëm.

Në figurën më poshtë është paraqitur në formë grafike progresi në zbatimin e veprimeve të planifikuara për arritjen e objektivit strategjik 3.

Figura 3: Progresi i zbatimit të veprimeve për arritjen e objektivit strategjik 3



(iv) OBJEKTIVI STRATEGJIK 4:

PËRMIRËSIMI I BESUESHMËRISË DHE CILËSISË SË SHËRBIMEVE TË UJIT

Vlerësimi për 17 veprimet e planifikuara për arritjen e këtij objektivi strategjik është si vijon:

- Kompletuar – 1
- Progres substancial – 7
- Progres i pjesshëm – 6
- Pa progres – 3

Progresi për këtë objektivi strategjik, në kuptimin kuantitativ të zbatimit të veprimeve është më i madhi krahasuar me objektivat tjera strategjike. Shkalla e zbatimit të veprimeve të planifikuara për arritjen e këtij objektivi strategjik është vlerësuar me $K=0.56$

Sa i përket zbatimit të veprimeve specifike, në mënyrë të përmblodhur mund të konkludohet si vijon:

- **Të kompletuara** është vlerësuar se është vetëm 1 veprim në kuadër të objektivit specifik *Menaxhimi i llumit të ujërave të ndotura*:
 - (i) Hartimi i planeve të menaxhimit të llumit nga ana e KRU-ve.
- **Progres substancial** është vlerësuar se është vlerësuar se ka pasur në 7 veprime, prej tyre 2 veprime në
- kuadër të objektivit specifik *Përmirësimi i procesit të investimeve në sektorin e shërbimeve të ujit*:
 - (i) Financimi i investimeve në infrastrukturën e ujësjellësit dhe kanalizimit nga buxheti i Kosovës bëhet përmes ME dhe KRU-ve,
 - (ii) Ndërprerja e praktikës për marrje të kredive të kushtëzuara për financimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit,2 veprime në kuadër të objektivit specifik *Përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat urbane*:
 - (iii) Financimi i projektit për rritjen e kapacitetit të F-kës së ujit të pijshëm në Pleshinë,
 - (iv) Financimi i projektit (ndërtimi i fundërruesit) për trajtimin e ujit të pijshëm për furnizimin e Klinës,2 veprime në kuadër të objektivit specifik *Zvogëlimi i humbjeve të ujit nga sistemet publike të ujësjellësit*:
 - (v) Hartimi dhe zbatimi nga KRU-të i planeve për zvogëlimin e humbjeve të ujit,
 - (vi) Zbatimi i llogaridhënies së KRU-ve për zvogëlimin e humbjeve të ujit,dhe 1 veprim në kuadër të objektivit specifik *Përmirësimi i mbulueshmërisë me rrjetin e kanalizimit të ujërave të ndotura*:
 - (vii) Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në Prizren, Gjakovë dhe Pejë
- **Progres i pjesshëm** është vlerësuar se ka pasur për 6 veprime të planifikuara, prej tyre 2 veprime për objektivin specifik *Përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat urbane*
 - (i) Hartimi i studimit për zgjidhjen e furnizimit me ujë në Malishevë
 - (ii) Rehabilitimi dhe përmirësimi i ujësjellësit në Gjilan, Kamenicë, Viti.2 veprime për objektivin specifik *Përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat rurale*:
 - (iii) Integrimi i sistemeve rurale në menaxhim të KRU-ve
 - (iv) Kompletimi i kyçjeve individuale në rrjetet e ujësjellësvedhe *nga 1 veprim* për objektivat strategjike *Përmirësimi i mbulueshmërisë me rrjetin e kanalizimit të ujërave të ndotura* dhe *Menaxhimi i llumit të ujërave të ndotura*:
 - (v) Ndërtimi i kolektorëve dhe rehabilitimi i rrjetit në Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Graçanicë
 - (vi) Investimi në incinerator
- **Pa progres** është vlerësuar për 3 prej veprimeve, prej tyre 2 në kuadër të objektivit specifik *Përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat urbane*:
 - (i) Financimi i projektit për rehabilitimin/kompletimin e tubacionit për furnizim me ujë të liqenit të Badovcit nga kanali i Ibrit
 - (ii) Financimi i projektit dhe kompletimi i punëve për rritjen e kapacitetit të burimeve të ujit në komunën e Mamushës.dhe 1 veprim në kuadër të objektivit specifik *Menaxhimi i llumit të ujërave të ndotura*:
 - (iii) Hartimi i strategjisë nacionale për menaxhimin e llumit.

Nga paraqitja e rezultateve të të dhënave të raportuara mund të shihet se progres më të madh sa i përket ndërmarrjes së veprimeve të planifikuara ka pasur sa i përket objektivit specifik *Përmirësimi i*


procesit të investimeve në sektorin e shërbimeve të ujit si dhe objektivit specifik *Zvogëlimi i humbjeve të ujit nga sistemet publike të ujësjellësit*, edhe pse për këtë të fundit nuk ka rezultate që dëshmojnë efektet e veprimeve të ndërmarra. Gjithashtu një progres mbi mesatare ka pasur edhe sa i përket zbatimit të veprimeve të planifikuara për objektivin specifik *Përmirësimi i mbulueshmërisë me sistemet e kanalizimit të ujërave të ndotura* duke pasur parasysh se është në përfundim kompletimi i projektit për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit në Prizren, Gjakovë dhe Pejë, si dhe janë në fazën finale përgatitjet për fillimin e projektit për rrjetin e kanalizimit për rajonin e Prishtinës.

Progres më të vogël ka pasur sa i përket objektivave specifike *Përmirësimi i furnizimit me ujë në zonat urbane* si dhe *Menaxhimi i llumit të ujërave të ndotura*.

Rrjedhimisht, **rekomandohet** që me prioritet të rritet dinamika dhe angazhimi në implementimin e aktiviteteve të planifikuara sidomos për Përmirësimin e furnizimit me ujë në zonat urbane (Projekti për mbushjen e Badovcit, Projekti për përmirësimin me ujë të Mamushës, Projekti për përmirësimin e furnizimit me ujë të Malishevës etj.), dhe për Menaxhimin e llumit të ujërave të ndotura (hartimi i strategjisë për menaxhimin e llumit). Gjithashtu, edhe përmirësimi me ujë në zonat rurale, përmes rehabilitimit të sistemeve ekzistuese dhe integritetit të tyre në KRU, rekomandohet të trajtohet me prioritet.

Në figurën më poshtë është paraqitur në formë grafike progresi në zbatimin e veprimeve të planifikuara për arritjen e objektivit strategjik 4.

Figura 4: Progresi i vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit strategjik 4




Vlerësimi përmblendës

Një pasqyrë përmblendhëse e progresit të vlerësuar në zbatimin e veprimeve të planifikuara për zbatimin e Strategjisë, është paraqitur në tabelën në vijim:

Table 1: Pasqyra përmblendhëse e progresit në zbatimin e veprimeve për arritjen e objektivave strategjike

Objektivat Strategjike	Kompletuar	Progres substancial	Progres i pjesshëm	Pa progres	Total
Objektivi Strategjik 1: Kompletimi i kuadrit ligjor dhe konsolidimi i kornizës institucionale	2	2	1	9	14
Objektivi Strategjik 2: Sigurimi afatgjatë i ujit dhe siguria e digave ekzistuese	5	1	1	6	13
Objektivi Strategjik 3: Mbrojtja e resurseve ujore dhe mbrojtja nga ujërat	3	5	8	10	26
Objektivi Strategjik 4: Përmirësimi i besueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve të ujit	1	7	6	3	17
Σ	11	15	16	28	70
Progresi (%)	15.7	21.4	22.9	40.0	100.0

Figura 5: Progresi në zbatimin e veprimeve të planifikuara me Strategji



Siç mund të shihet, për një numër të madh të veprimeve 28 prej 70 sa ishin planifikuar gjithsej – pra për 40% të veprimeve nuk ka pasur asnjë aktivitet/progres. Duke pasur parasysh se kanë mbetur rreth 15 muaj deri në fund të vitit 2025 që është afati për zbatimin e të gjitha veprimeve të planifikuara me Planin e Veprimit 2023–2025, është vështirë të pritët që të gjitha këto veprime të kryhen brenda afatit të përcaktuar me Strategji. Në këtë kontekst, duhet theksuar veçanërisht mungesën e progresit në veprimet e planifikuara për Digën e Firajës si dhe Digën e Livoçit, pastaj për hartimin e një strategjie për menaxhimin e llumit të ujërave të ndotura, si dhe për mbrojtjen e lumenjve nga nxjerrja e pakontrolluar e zhavorrit dhe rërës.


Progres të pjesshëm ka pasur për 16 prej veprimeve të planifikuara (afër 23%). Për shumicën e këtyre veprimeve duhet të shtohet dinamika e e punës dhe angazhimit në mënyrë që të kompletohen brenda afatit të planifikuar (deri në vitin 2025). Kjo në veçanti vlen për veprimet që kanë të bëjnë me ndërtimet e impianteve të ujërave të ndotura që janë planifikuar për zonat urbane të Kosovës (rajoni i Prishtinës, Mitrovicës, Gjilani, Ferizaj etj.), pastaj për mbikëqyrjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura industriale, si dhe për aktivitetet e planifikuara për përmirësimin e furnizimit me ujë në zonat urbane (Malisheva, Mamusha, Klina, Kamenica, Ferizaj etj.) dhe në zonat rurale (rehabilitimi dhe integrimi i sistemeve rurale të ujësjellësit në KRU).

Progres substancial ose të kompletuara plotësisht janë raportuar 26 veprime të planifikuara, ose mbi 37%. Këtu vlen të përmenden sidomos aktivitetet e zhvilluara për zhvillimin e resurseve të reja ujore si hartimi i studimeve të fizibilitetit për digat e Pollatës, Kuçicës dhe Dragaqinës, pastaj pajisja e digave ekzistuese me instrumente të monitorimit dhe me sisteme të alarmit, si dhe veprimet për hartimin e legjislacionit në fushën e ujërave – koncept dokumentit si dhe draftit të Ligjit për Menaxhimin e Resurseve Ujore dhe draftit të Ligjit për Financimin e Menaxhimit të Ujërave.

Në grafikun më poshtë është paraqitur një pasqyrë krahasuese sa i përket veprimeve të ndërmarra për zbatimin e objektivave strategjik. Siç mund të shihet, është vlerësuar se më së shumti veprime janë ndërmarrë për *Objektivin Strategjik 4: Përmirësimi i Besueshmërisë dhe Cilësisë së Shërbimeve të Ujit* ku progresi është vlerësuar me koeficientin 0.56 (nga 0-1), pastaj për *Objektivin Strategjik 2: Zhvillimi i*

Resurseve të Reja Ujore dhe Siguria e Digave – progresi i vlerësuar e koeficientin 0.48, ndërsaq progresi më i vogël është vlerësuar për *Objektivin Strategjik 1: Kompletimi i Kuadrit Ligjor dhe Konsolidimi i Kornizës Institucionale* ku progresi është vlerësuar me koeficientin 0.29. Në anën tjetër, progres modest ka pasur në ndërmarrjen e veprimeve për arritjen e *Objektivit Strategjik 3: Mbrojtja e Ujërave dhe Mbrojtja nga Ujërat* ku progresi është vlerësuar me koeficientin 0.41.

Figura 6: Krahasimi i progresit në zbatimin e veprimeve për Objektivat Strategjike





**Funded by
the European Union**

Ky publikim është zhvilluar si pjesë e projektit “Promovimi i qasjes universale në ujë të pastër, financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe implementuar nga Rilindja Gjellbër (is Let’s Do It Peja).

Pikëpamjet, opinionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë publikim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

Rilindja Gjellbër

Adresa: Shtëpia e Kulturës, kati III

30000, Pejë, Kosovë

Email: info@rilindja-gjelber.org

Tel: +383 49 124 548

www.puacw.ldip.com



Promoting Universal
Access to **Clean Water**